



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

### E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

i mbledhjes së gjashtë i Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 27.6.2024, duke filluar në orën 9:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Dhurata Jahaj Retkoceri, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Mirsad Vitia dhe Bahri Gashi

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përparim Rama-Kryetar i Kryeqytetit, Jehona Lushaku - nënkyetare, Arbër Sadiki - drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Mjedisor, Fatos Dibra - udhëheqës i Zyrës ligjore, Osman Bllaca - auditor, Valbona Ahmeti-Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Lulzim Fushtica - drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë dhe Bardh Krasniqi – drejtor i Drejtorisë së Sportit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoit, Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, me këtë:

#### REND DITE

1. Propozim-vendimi për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024;
2. Propozim-vendimi për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027(KAB);
3. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të projektdokumentit: Projekt - Plani i zhvillimit komunal 2024-2032( PZHK);
4. Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcializimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (të banimit individual) të Planit rregullues Prishtina e Re - Zona perëndim, dhe ndërrimin e destinimit të BLL.I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së , në Prishtinë;
5. Projektkodi i etikës për zyrtarët e kryeqytetit;
6. Propozim-vendimi për përkrahje financiare të klubeve sportive të kryeqytetit dh Eventit sportiv 3x3 Prishtina;
7. Propozim-vendimi për themelimin e Komisionit të Kuvendit lidhur me shfrytëzimin e Banesave të Komunës së Prishtinës në Bregun e Diellit, Fusha e Pajtimit dhe në Hajvali;

- 8. Raporti i përgjithshëm i punës për Ndërmarrjen publike lokale ”Stacioni i Autobusëve”, SH.A, Prishtinë;**
- 9. Informatë mbi punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;**
- 10. Të ndryshme.**

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, kryesuesi tha se e ka pasur një kërkesë prej Zyrës ligjore që ka mbërrit me vonesë ka qenë Propozim-vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale Komunës së Prishtinës me pronën e paluajtshme në pronësi të 4A SHPK, nuk e kam fut në rend dite nëse ju jeni të pajtimit këtu në rregullës eshtë.

**Fatos Dibra:** tha se kërkesa ka ardhur prej Drejtorisë së Pronës.

**Gëzim Sveçla:** pyeti se në pikën 3 të rendit të ditës a ka ndryshuar diçka prej herës së kaluar që ka ardhur në KPF **Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të projektdokumentit: Projekt - Plani i zhvillimit komunal 2024-2032 (PZHK).**

**Arbër Sadiki:** u përgjigj se janë përmirësuar vërejtjet e paraqitura nga Nora.

**Gëzim Sveçla:** tha nëse nuk ka ndryshuar asgjë mendoj se arsyet ligjore vazhdojnë të qëndrojnë pse kjo pikë nuk duhet të trajtohet se i ka 28 vërejtje prej Ministrisë së Ambientit dhe eshtë mirë me larguar prej pikave të rendit të ditës. Po ashtu tha se një arsyetim që ka ardhur ka qenë një vendim gjyqësor këtu nuk po përmendet askund vendimi gjyqësor, këtu në propozim po përmendet një PZHU dhe sa kam njohuri Komuna e Prishtinës nuk ka PZHU valide, pra pyetja eshtë a ka PZHU aktuale për sa vite ka qenë e bërë.

**Arbër Sadiki:** dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

**Gëzim Sveçla:** tha se në faqe të Komunës së Prishtinës po thotë PZHU Prishtina 2012-2022 e ke sjell një propozim me bërë ose me ndryshuar një plan sipas destinimit të PZHU së vitit 2022. Unë propozoj me i larguar pikën 3 dhe 4 nga rendi i ditës.

**Fatos Dibra:** dha sqarime shtesë për këto dy pika lidhur me opinionin ligjor të ministrisë.

**Gëzim Sveçla:** pyeti se a mundemi me pa atë opinion ligjor të ministrisë.

**Fatos Dibra:** tha se besoj se mund të gjendet.

**Milazim Vitija:** tha se sa i përket kësaj pike në vitin 2012 kam qenë hartues i PZHK dhe PZHU 2013-2024 sa e di unë, unë jam i pajtimit që kjo pikë të jetë në rend dite dhe të kalojë normal ka me pasur vërejtje dhe sugjerime ka me shkuar në diskutim publik, kanë m'i dhënë qytetarët vërejtjet dhe sugjerimet e tyre inkorporohen dhe do të jenë edhe vërejtjet dhe sugjerimet tona dhe do ta votojmë kurë të vjen.

**Leutrim Retkoceri:** tha se në mbledhjen e kaluar të Komitetit për Politikë e Financa kemi kërkuar disa dokumente shtesë që drejtori dhe kryesuesi i Zyrës ligjore me na sjell komunikimet zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe ministrisë dhe çka ju ka kthyer ministria, kështu që as drejtori që as zyrtari i Zyrës ligjore nuk janë ata që e kanë filluar as përfunduar dokumentin që na kanë sjell këtë rrethanë është mirë me na sqaruar. Dokumentet që na i keni sjell për pikën 3 për me vë në diskutim publik PZHK, është me pëlqim mjedisor të vitit 2021 ku në ligj thuhet se nuk është valide se duhet me qenë 6 muaj më i vjetër e jo 3 vjet e gjysmë më i vjetër, ju jeni duke e shkel ligjin me qëllim. Po ashtu tha se kur flasim për interpretim të ligjeve është mirë Zyra ligjore me na sjell dokumente ligjore, me na i treguar. Qëndrim i grupit tonë është që pika 3 dhe 4 me u larguar nga rendi i ditës derisa të na vjen i kompletuar materiali dhe në përputhje të plot me ligjin.

**Fatos Dibra:** dha sqarime lidhur me çështjet e parashtuara nga parafolësi.

**Nora Kelmendi:** tha drejtor ju thatë që i keni bërë ndryshimet për PZHK –në, mua nuk më hapet asnjë fail që e keni dërguar, herën e kaluar është hapur dhe i kam pasur vërejtjet e mia kësaj here nuk hapet me i shikuar a i keni inkorporuar ato vërejtjet.

**Arbër Sadiki:** tha pasi i kam dërguar materialet kam shikuar të gjitha materialet më janë hapur dhe jam në gjendje me ju prezantuar nëse jeni të interesuar ju për çdo gjë.

**Nora Kelmendi:** tha kam një pyetje për pikën 4 në vendim e keni vendosur në nenin 5 që subjekti përgjegjës për ndryshimin e këtij plani është Drejtoria e Planifikimit Strategjik, a ekziston kjo drejtori ende.

**Bahri Gashi:** shprehi shqetësimin lidhur me materialet që nuk po hapen, andaj tha kishte qenë mirë me hapur një icloud online dhe e dërgoni kodin dhe të gjitha materialet merren aty se po kemi problem me internet të Komunës së Prishtinës.

**Vigan Kastrati:** tha se kanë marrë masa janë duke biseduar me zyrën e ATI me formuar një server të brendshëm ku materialet që janë në serverin e brendshëm me u ruajtur dhe me pasur qasje e me hy drejtpërdrejtë, ndoshta na merr pak kohë se jemi duke punuar në atë drejtim se po kemi problem edhe në telefona nuk po hapen shumica e emaileve. Ka shumë probleme me nivelin qendror, kemi marrë hapat e nevojshëm për të krijuar një softwer të brendshëm të komunës ku të gjitha failat ruhen.

**Leutrim Retkoceri:** tha një pyetje për Zyrën ligjore a mundesh me na gjete bazën ligjore që justifikon që material, llogaritet që dërgimi i materialit asamblistëve u hi transferi që hiqet pas 7 ditëve, a ma gjen bazën ligjore.

**Fatos Dibra:** tha jo kjo është çështje teknike, nuk ka baza ligjore.

**Vigan Kastrati:** tha se është e vërtetë se komuna nuk ka për momentin një server, kemi biseduar edhe me ASHI se a do të na lejojnë me krijuar atë, por ne do të vazhdojmë me krijuar atë, për momentin e vetmja zgjidhje është momentale tani edhe një dokument një fail sa më të vogël as USB nuk ke mundësi me përdorë në kompjuterët tonë jemi të bllokuar prej nivelit qendror.

**Gëzim Sveçla:** ju drejtua drejtorit se miratimi i çdo akti ka një procedurë po na fton ndoshta në aspektin profesional me diskutuar përbajtjen e dokumentit, mirëpo përbajtjes i paraprinë procedura ne kemi probleme procedurale, probleme ligjore, të cilat pa i eliminuar nuk mundemi me fol për përbajtje. Po ashtu tha se kemi një kërkesë prej familjes Krasniqi lidhur me pllakën për dëshmorin Ismet Krasniqi e cila na është drejtuar asamblesë në vitin e parë të këtij mandati në vitin 2022. Infrakosi e ka dhënë pëlqimin për ndërtimin e pllakës, bëhet fjalë për lokacionin te Xhamia e Madhe aty ku është vrarë dëshmori, por në anën tjetër Drejtoria e Urbanizmit nuk ka lëvizur me këtë projekt, ju kisha lutur me përfunduar këtë çështje.

**Leutrim Retkoceri :** pyeti se në dokumentet që na janë bashkangjitur është vendimi për pëlqim mjedisor për raportin strategjik mjedisor të PZHK të Komunës së Prishtinës viti 2021 a është ky Plan Zhvillimor që e keni punuar i riu apo ai i Shpend Ahmetit, cilën e keni sjell, pse nuk është i vitit 2024.

**Fatos Dibra:** dha sqarime për çështjen e ngritur nga parafolësi.

**Leutrim Retkoceri:** tha pyetja ime është e ke një pëlqim mjedisor të PZHK të vitit 2021, a na e keni sjell PZHK të vitit 2021 me votuar në vitin 2024 apo e ke sjell planin e ri.

**Arbër Sadiki:** u përgjigj se Plani i ri qëndron.

**Leutrim Retkoceri:** tha se jemi duke folur për një PZHK të vitit 2024 me pëlqimin e një Plani tjetër 2021, në këtë situatë nuk mundesh me votuar për një plan për dëgjim publik me një lajthitje e tanë pasi të kryhet dëgjimi publik me prit pëlqimin. Ligji për Panifikim Hapësinor ta tregon saktë procedurën për PZHK, pëlqimi mjedisor m'u marrë përpara dëgjimit dhe para se m'u votuar nuk e keni marrë jeni duke e përdorë të vitit 2021.

**Kryesuesi:** tha janë dy propozime me tërhiq pikën 3 dhe 4, një pyetje për Zyrën ligjore çka thotë ligji munden m'u hiq nga rendi i ditës pikat në KPF apo mund të rekomandohet.

**Fatos Dibra:** tha se Udhëzimi administrativ thotë: KPF-ja voton rekomandime dhe rendi i ditës në bazë të Ligjit është kompetencë ekskluzive e kryesuesit dhe kryetarit të komunës.

**Gëzim Sveçla:** tha praktikat krijohen kur ka zbrastira ligjore, tash nuk ka një dispozitë ligjore, e cila e ndalon KPF me hjek një pikë të rendit të ditës, a ka.

**Leutrim Retkoceri:** tha se Udhëzimi administrativ, nen 11 fol për komitetet.

**Fatos Dibra:** tha kjo është për të gjitha komitetet d.m.th rekomandimet e komiteteve të përherershme merren me shumicë të votave të anëtarëve të pranishëm. Kuvendi ka të drejtë para miratimit të rendit të ditës me heq një pikë ose me shtuar një pikë.

**Kryesuesi:** tha se rekomandimet shkojnë në Kuvend për me i tërhiq, këtu nuk po i përheqim po i dërgojmë në Kuvend.

**Milazim Vitija:** tha ne zakonisht kur nuk ka pasur prezantim prej drejtorive për pikën e rendit të ditës e kemi tërhoq, në këtë rast e kemi drejtorin i dha sqarimet e duhura le të vendos Kuvendi.

**Jeta Rafuna:** pyeti se këto rekomandime a duhet të votohen këtu.

**Bahri Gashi:** tha se nuk votohet rekomandimi.

**Kryesuesi:** pyeti se këto rekomandime a kanë mu votuar në Kuvend a jo.

**Fatos Dibra:** dha sqarime.

**Leutrim Retkoceri:** tha se KPF qe dy mandate rend edhe propozon dhe hiq pika, ligji nuk ta ndalon, momentin që ta ndalon komiteti nuk ka të drejtë me fut pika. Udhëzimi administrativ që po përdoret tani është për të gjitha komitetet dhe i referohet komiteteteve të përhershme dhe çka thotë: mbrojtje të temave të tyre kanë të drejtë me rekomanduar Kuvendin, kjo nuk është temë e jona, duhet me lyp interpretim ligor nga organi mbikëqyrës që është në MAPL, le të shkon Zyra ligjore të bëjë interpretim dhe neve të na kthehet interpretimi i organit mbikëqyrës kompetent.

**Fatos Dibra:** dha sqarime shtesë.

**Kryesuesi:** kërkoi interpretimin e ligjit siç është, a mundemi na me shkuar nëse ka bazë ligjore i largojmë pikat, nëse nuk ka bazë ligjore vetëm rekomandim atëherë rekomandimet i dërgojmë në Kuvend dhe në Kuvend votohen, këtë opinion po e kërkoj.

**Fatos Dibra:** dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga kryesuesi.

**Gëzim Sveçla:** tha po vazhdojmë siç kemi vazhduar deri tani deri në seancën e radhës Zyra ligjore obligohet me marrë një opinion ligor me pyetje shumë të thjesht a ka të drejtë KPF – ja me larguar pika nga rendi i ditës.

**Përparim Rama:** tha çka ka ndodhur qe 7 vite janë gjëra që kanë ndodhur qe 7 vjet, unë mendoj që kryetari e ka vizionin për të cilin edhe është votuar prej qytetarëve të Kryeqytetit për me shty këtë vizion përpara, kryetari me kryesuesin merren vesh për rendin e ditës dhe ky është rendi i ditës nëse doni ju t'i largoni pikat, i largoni në Kuvend e jo këtu, kjo është kërkesa jonë dhe është kërkesë legitime dhe kjo duhet të shkojë përpara.

**Gëzim Sveçla:** tha vizionin mundesh me shty është i yti kur ti kesh votat mundesh me shty.

**Bahri Gashi:** tha na mundem në Kuvend m'i hiq cilëndo pikë që dëshirojmë, t'i kalojmë këto pika këtu e në kuvend i propozojmë.

**Jehona Lushaku:** tha ju nuk jeni e vetmja KPF në Kosovë ka edhe komuna tjera që e ndjekin një praktikë dhe e respektojnë ligjin, t'i shikojmë edhe komunat tjera si po veprojnë në KPF dhe kërkonit zyrtarisht një interpretim.

Kryesuesi e hodhi në votim pikën e tretë **Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të projektdokumentit: Projekt - Plani i zhvillimit komunal 2024-2032( PZHK)** për me ia rekomanduar Kuvendit për me heq nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se me 5 pika për, 3 kundër dhe 2 abstenime, dhe Bahri Gashi nuk voton hiç që **Propozim-vendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), 2024-2032** u miratua që me ia rekomanduar Kuvendit me heq nga rendi i ditës.

Kryesuesi e hodhi në votim pikën e katërt **Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcializimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (të banimit individual) të Planit rregullues Prishtina e Re - Zona perëndim, dhe ndërrimin e destinimit të BLL.I-1, Q-2, I-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së , në Prishtinë** për me ia rekomanduar Kuvendit për me heq nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se me 5 pika për, 3 kundër dhe 2 abstenime, dhe Bahri Gashi nuk voton hiç që **Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcializimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (të banimit individual) të Planit rregullues Prishtina e Re - Zona perëndim dhe ndërrimin e destinimit të BLL.I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së , në Prishtinë** u miratua që me ia rekomanduar Kuvendit me heq nga rendi i ditës.

#### **Pika e parë**

#### **Propozim-vendimi për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024.**

Lidhur me **Propozim-vendimin për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024** në pika të shkurta dha sqarime **Valbona Makolli**, siç ju kam treguar në mbledhjen e kaluar Ministria e Financave këtë vit e ka bërë vetë rialokimin e mjeteve të të hyrave vetanake duke e hequr granditin qeveritar për projektet të cilat nuk janë realizuar. Këto janë investime kapitale, secili prej drejtoreve ka me paraqit pse e ka pa të arsyeshme ta bëjë rialokimin, shkaku kryesor është 90% për shkak të grandit qeveritar dhe këto projekte as nuk janë hiç, janë bartur këtë vit, por janë vetëm rialokim i mjeteve veç se puna është duke vazhduar.

**Kryesuesi:** tha se u përkrah **Propozim-vendimi për rialokimin e mjeteve të bartura në vitin 2024** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e dytë**

#### **Propozim-vendimi për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027 (KAB).**

Lidhur me **Propozim-vendimi për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027(KAB)** në pika të shkurta dha sqarime **Valbona Makolli**, tha KAB është propozim i drejtoreve, kuptohet me propozimin e kryetarit që parashihen për tri vitet e ardhshme. Të gjitha drejtoritë komunale kanë propozuar investime kapitale, se KAB bëhet vetëm për investime kapitale, prej propozimeve të drejtoreve shumica e investimeve kapitale kanë kaluar në Drejtorinë e implementimit të projekteve, por janë propozime të drejtoreve.

**Kryesuesi:** tha se u përkrah **Propozim-vendimi për miratimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2025-2027(KAB)** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e tretë**

**Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të projektdokumentit: Projekt - Plani i zhvillimit komunal 2024-2032 (PZHK).**

**Pika e katërt**

**Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcializimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (të banimit individual) të Planit rregullues Prishtina e Re - Zona perëndim dhe ndërrimin e destinimit të BLL.I-1, Q-2, I-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, në Prishtinë.**

**Kryesuesi:** tha sa i përket këtyre dy pikave 3 dhe 4 u votuan më herët për me iu drejtuar Kuvendit me rekomandim për me i larguar nga rendi i ditës.

**Pika e pestë**

**Projektkodi i etikës për zyrtarët e kryeqytetit**

Lidhur me **Projektkodin e etikës për zyrtarët e kryeqytetit** në pika të shkurta dha sqarime **Vigan Kastrati**, tha se Komuna jonë ka mungesë të kodit të etikës, i cili ka vite të tëra që është rekomanduar nga MAPL. Kemi marrë iniciativën në dhjetor kemi kërkuar nga ministria një draft dhe na ka dërguar draftin sipas një komisioni kemi përfunduar draftin, e kemi dërguar në dhjetor apo janar në Zyrën ligjore për lexim ka kaluar, kemi pasur diskutim edhe me sindikatën dhe propozoj që Kodi i etikës duhet me kaluar sepse është i nevojshëm edhe për komunën tonë.

**Gëzim Sveçla:** tha është e rëndësishme kjo çka tha drejtori në fund që e ka kaluar në Zyrën ligjore për shkak se ky kod në shumë pika të tij bie në ndesh me ligjin, prandaj kishte qenë mirë me qenë zyrtari ligjor, si i tillë që është nuk mendoj se është një projektkod adekuat dhe nuk përkon me nivelin e Kuvendit Komunal të Prishtinës.

**Vigan Kastrati:** tha se e ka një shqetësim në lidhje me këtë sepse edhe herën e kaluar i keni dhënë disa rekomandime të cilat i kemi marrë i kemi përmirësuar, unë e kam një shqetësim se ky kod ka ardhur në email te të gjithë asamblistët, është dërguar edhe te ju dhe nuk ka kthyer askush rekomandim apo vërejtje dhe ne e kemi marrë si tërësi, nuk është diçka që ka një urgjencë nëse e shihni se ka diçka në kundërshtim me ligjin, ka nevojë për rekomandime nuk kemi nevojë me shty përpara, ne mundemi edhe me larguar nëse ka shqetësime të cilat duhet trajtuar.

**Kryesuesi:** tha në seancë i japim rekomandimet.

**Bahri Gashi:** tha si irregullore për kod të veshjes ishte e ngarkuar, ekziston ligji a mundeni pak me shkarkuar.

**Vigan Kastrati:** tha se i kanë marrë të gjitha rekomandimet që kanë dalë në komitet dhe i kanë inkorporuar, ajo që është me rëndësi se jemi e vetmja komunë në nivel të Kosovës që nuk kemi kod etik se nuk e kanë shtyrë përpëra më herët. Me ardhjen time në vitin e kaluar unë e kam marrë si projekt kryesor dhe e kam shtyrë përpëra, kurse tani ka has në disa vërejtje. Ne e kemi bërë një mbidraft, e kemi bërë një komision, kemi pritur rekomandime, e kemi dërguar në Zyrën ligjore, te prokurimi, e kemi thirr edhe sindikatën dy herë në takime, as prej sindikatës nuk kemi marrë rekomandime për ta larguar këtë kod, ne kemi menduar që jeni të pajtimit dhe e kemi sjellë prapë.

**Nora Kelmendi:** tha drejtor ju thatë se është formuar komisioni, a mundemi me ditë sa ka zgjat përpilimi i këtij dokumenti para 6 muajve e ke sjell.

**Vigan Kastrati:** u përgjigj se komisioni ka qenë i formuar në vitin e kaluar dhe dokumenti është përpiluar për 1 muaj.

**Kryesuesi:** tha se u përkrah **Projektkodi i etikës për zyrtarët e kryeqytetit** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### **Pika e gjashtë**

**Propozim-vendimi për përkrahje financiare të klubeve sportive të kryeqytetit dhe Eventit sportiv 3x3 Prishtina.**

**Nora Kelmendi:** tha nuk e di a e keni parë raportin e auditimit të vitit 2023, se e kanë publikuar ka dal dhe një prej rekomandimeve është subvencionet me u nda me thirrje publike, përvèç thirrjeve publike kanë kërkuar edhe raporte, i kemi dy të gjatura për subvencione në raportin e 2023 edhe në 2022 i keni pasur njëjtë, paraqes pyetjen a qëndron kjo.

**Fatos Dibra:** dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga parafolësja.

**Gëzim Sveçla:** tha po flasim për subvencionet e OJQ-ve, me Rregullore për financimin e OJQ-ve, a i ka kontrolluar këto dokumente që i kemi sot në seancë të sportit, a i ke kontrolluar si Zyrë ligjore.

**Fatos Dibra:** u përgjigj se materialet i kontrollon para se me shkuan në seancë, nuk mundem me fol nëse nuk më vinë paraprakisht, jo nuk i kom kontrolluar.

**Gëzim Sveçla:** tha d.m.th nuk i ke kontrolluar, si mundet me ardhur një material drejtor pa kontroll të Zyrës ligjore.

**Nora Kelmendi:** tha se në rekomandimin që ka dal para dy dite është rekomandimi që kryetari është pajtuar rekomandimi i auditorit, e gjetura është vetëm në 5 raste, vlera mbi 260 mijë euro ku komuna kishte ndarë subvencione OJQ-ve duke mos aplikuar thirrjen publike, por vetëm me Vendim të Kuvendit Komunal. Te rekomandimi kryetari duhet të sigurojë në rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve të aplikohen thirrjet publike sipas kërkësës së rregullores në fuqi dhe këtu është duke folur për thirrje publike për sport.

**Bardh Krasniqi:** pyeti se kur ka dal kjo, qe sa rekomandohet, qe sa vite.

**Nora Kelmendi:** tha se dy ditë ka dal rekomandimi i auditorit dhe ju nuk e përfillni.

**Gëzim Sveçla:** tha se na po flasim për shkeljet ligjore.

**Bardh Krasniqi:** tha se ka biseduar me auditorin e brendshëm dhe të jashtëm.

**Gëzim Sveçla:** tha se në mënyrën siç është nuk është në rregull. Këto dokumente janë të jashtëligjshme në këtë mënyrë siç po do me i nda subvencionet janë të jashtëligjshme, ti po bën thirrje me votuar për diçka të jashtëligjshme. Kur kemi norma ligjore pse duhet me i shfrytëzuar praktikat pyetje për Zyrën ligjore.

**Fatos Dibra:** dha sqarime për pyetjen e parashtuar nga parafolësi.

**Kryesuesi:** tha se u përkrah **Propozim-vendimi për përkrahje financiare të klubeve sportive të kryeqytetit dhe Eventit sportiv 3x3 Prishtina** dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Gëzim Sveçla:** kërkoi që herëve tjera KPF-ja mos me qenë të njëjtën ditë me seancë.

**Kryesuesi:** tha se sot shkoi kështu e herëve tjera e thërrasim mbledhjen më herët dhe diskutojmë, sot e kemi kështu, mund të diskutojmë tanë që e kemi mbledhjen të njëjtat tema kanë me qenë.

**Gëzim Sveçla:** tha nuk ka pas nevojë kështu, jemi pajtuar që nesër e premte më datë 28 të mbahet mbledhja, kur të merremi vesh duhet me iu përbajt.

**Kryesuesi:** tha se ka biseduar me kryetarin dhe kryetari më datë 28 ka thënë se ka me udhëtar, kjo është arsyja që po mbahen sot dy mbledhjet në të njëjtën ditë. Unë po pajtohem se është gabim të mbahet të njëjtën ditë edhe KPF dhe Kuvendi.

#### Pika e shtatë

**Propozim-vendimi për themelimin e Komisionit të Kuvendit lidhur me shfrytëzimin e Banesave të Komunës së Prishtinës në Bregun e Diellit, Fusha e Pajtimit dhe në Hajvali**

**Kryesuesi:** tha se lidhur më këtë pikë është dashur me qenë Shkëmb Manaj se drejtoresha sepse pronës ka rast vdekje.

**Kryesuesi:** e shpalli të mbyllur mbledhjen për të vazhduar më tutje në seancë.

*Mbledhja përfundoi në orën 10:40 .*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesues i Komitetit  
Fehmi Kupina**

